




15






KOSTT SH.A. është Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, i themeluar me 1 korrik 2006, kompani publike me 100 % të aksioneve shtetërore. Sipas Ligjit për energjinë elektrike nr.05/L-085 të miratuar në vitin 2016, të drejtat e aksionarit ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KOSTT menaxhon Sistemin e Transmetimit të Republikës së Kosovës duke operuar me nivele të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110 kV. Sistemit të transmetimit i përkasin edhe transformatorët e ndërlidhur me rrjetin e shpërndarjes: 220/35/10 kV dhe 110/35/10(20) kV.

Përgjegjësi e KOSTT është që në mënyrë të sigurt dhe të besueshme të transmetojë energjinë elektrike nga njesitë e gjenerimit deri te sistemi i shpërndarjes, 24 orë në ditë, 365 ditë në vit. Aktualisht, rrjeti i transmetimit të Kosovës lidhet me shtetet fqinje përmes tetë linjave ndërkufitare.

Falë pozitës qendrore gjeografike që ka shteti ynë, sistemi i transmetimit me të cilin operon KOSTT, edhe pse i vogël, paraqet një nyje shumë të rëndësishme të transmetimit në Evropën Juglindore.





Misioni i KOSTT

Operimi i sigurt dhe i besueshëm i Sistemit të transmetimit, duke garantuar sigurinë e furnizimit, si dhe operimin efikas të tregut të energjisë elektrike në bazën e transparencës dhe jo diskriminimit, në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Kosovës.

Vizioni

“Të jetë kompani kredibile, që garanton transmetimin e sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike, e përgjegjshme në kuptimin social dhe mjedisor, e integruar në rrjetet dhe institucionet evropiane të transmetimit të energjisë elektrike”.

Vlerat themelore të KOSTT



Siguria dhe
Besueshmëria



Përgjegjësia



Bashkëpunimi



Transparenca




Dija

Investimet e KOSTT 2006-2021- afër €240 Milion

Kapacitetet bartëse të Rrjetit Intern të Transmetimit (MW)	Viti 2006	Viti 2021	Përqindja e rritjes 2006/2021 %	Numri i transformatorëve të KOSTT (Rrjeti Horizontal)	Viti 2006	Viti 2021	Përqindja e rritjes 2006/2021 %
	930	1870	101%		0	65	
Gjatësia e përgjithshme e linjave, km	Viti 2006	Viti 2021	Përqindja e rritjes 2006/2021 %	Kapacitetet transformuese MVA (rrjeti horizontal)	Viti 2006	Viti 2021	Përqindja e rritjes 2006/2021 %
	1057	1430,3	35%		2200	3750	70%
Gjatësia e linjave 400 kv, km	Viti 2006	Viti 2021	Përqindja e rritjes 2006/2021 %	Kapacitetet transformuese MVA (rrjeti vertikal)	Viti 2006	Viti 2021	Përqindja e rritjes 2006/2021 %
	181	280	54%		0	2320	
Gjatësia e linjave 220 kv, km	Viti 2006	Viti 2021	Përqindja e rritjes 2006/2021 %	Kapacitetet transformuese totali MVA	Viti 2006	Viti 2021	Përqindja e rritjes 2006/2021 %
	232	239	3%		2200	6070	176%
Gjatësia e linjave 110 kv, km	Viti 2006	Viti 2021	Përqindja e rritjes 2006/2021 %	Numri i Nënstacioneve të KOSTT	Viti 2006	Viti 2021	Përqindja e rritjes 2006/2021 %
	644	912	42%		30	38	27%
Numri i transformatorëve të KOSTT (Rrjeti Vertikal)	Viti 2006	Viti 2021	Përqindja e rritjes 2006/2021 %	Linja interkonektive 400/220/110 kv	Viti 2006	Viti 2021	Përqindja e rritjes 2006/2021 %
	10	16	60%		7	8	14%

Numri i Punëtorëve



Zhvillimi i Rrjetit të Transmetimit të Kosovës



Linja e parë 110 kV u ndërtua në vitin 1955:
NS Vallaç-NS Butel
Linja e parë 220 kV u ndërtua në vitin 1960:
TC Kosova – NS Krushevc
Linja e parë 400 kV u ndërtua në vitin 1977:
NS Kosova B – NS Nish.

Funksionet e transmisionit dhe dispeçingut, ishin pjesë e Korporatës Elektroenergjetike të Kosovës (KEK) e cila funksiononte si një ndërmarrje vertikalisht e integruar. Këto funksione u ndanë dhe me **1 korrik të vitit 2006** u themelua Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a - kompani publike me 100 % të aksioneve shtetërore,ku të drejtat e aksionarit ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës.



4 tetor 2006 - KOSTT licencohet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZrRE) për:
operim të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe operim të tregut të energjisë elektrike në Kosovë.

Projektet kapitale me ndikim

Paket projekti Peja 3

inauguruar me
17 Nëntor 2009



SCADA EMS dhe Telekomit

inauguruar me
1 korrik 2011



Paket projekti Ferizaj 2

energizuar me
18 tetor 2011



Linja 400 kV Kosovë-Shqipëri

– e energjizuar në pjesën e Kosovës me 17 dhjetor 2015 dhe e inauguruar me 28 qershor 2016 në NS Tirana 2 (Shqipëri)




Nënstacioni 110/10 (20)kV Ilirida
dhe linjat nëntokësore transmetuese 110 kV-inauguruar me 19 qershor 2019



Nënstacioni 220/10(20)kV Drenas
dhe linja e dyfishtë transmetuese 220kV inauguruar me 27 qershor 2019



Nënstacioni 110/10 (20) kV Dardania
dhe linjat nëntokësore kablllore 110 kV-tetor 2019



Paralel me zhvillimin e Sistemit të Transmetimit, KOSTT po ashtu ka ndërtuar dhe zhvilluar **rrjetin e ri telekomunikues** të bazuar në **fibra optik OPGW**, me gjatësi prej 1210 km të vendosur nëpër largpërçues të tensionit të lartë



- Dhjetor 2010 - KOSTT sh.a - kompania e parë publike në vend që çertifikohet me Standardin **ISO 9001:2008**

- Maj 2017 – KOSTT ndër kompanitë e para publike që çertifikohet me tri standarde ndërkombëtare: **ISO 14001:2015**; OHSAS 18001:2007 (**ISO 45001:2018** në v.2021) dhe **ISO 9001:2015**

- Dhjetor 2021-KOSTT çertifikohet me Standardin e Sigurisë së **Informacionit ISO 27001:2013**



1 tetor 2015 – në Bruksel u nënshkrua Marrëveshja e parë për Kyçje të Sistemit Energjetik të Kosovës në Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale, në mes të KOSTT dhe ENTSO-E. (nuk është implementuar)




15 shkurt 2019 – Bordi i ZRRE mori vendimin final për **çertifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit** (OST – KOSTT), pas opinionit mbështetës nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore, sipas Pakos së Tretë të BE për Energji.



26 Nëntor 2019 në Tiranë - u nënshkrua **Marrëveshja e themelimit të Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK)** në mes të KOSTT dhe OST Shqipëri.



20 prill 2020 - Përmbyllet me sukses **votimi i Marrëveshjes së re të Kyçjes KOSTT/ENTSO-E** nga Grupi Regjional i Evropës Kontinentale (RGCE). **Marrëveshja u nënshkrua me 30 qershor 2020.**



18 qershor 2020 – Rrjeti i Transmetimit të Kosovës plotëson **kriterin Teknik të sigurisë së furnizimit N-1** me vënien në operim të linjës së re 110 kV, NS 110/35/10(20)kV Rahoveci-NS 110/35/10(20)kV Theranda. Projekti në vlerë prej 1.43 milion Euro, u bashkë-financua me BERZH.



5 tetor 2020 në Prishtinë – **Themelohet Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX)** nga OST Shqipëri dhe KOSTT, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Aksionarëve dhe miratimin e Statutit të ALPEX.





14 Dhjetor 2020 – **Hyri në fuqi Marrëveshja e re e Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E** dhe si rezultat:

– **Fillon operimi** i KOSTT si Zonë e pavarur rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë (**Biloku AK**)

– Funkcionalizohet komercialisht linja interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri, e njohur si **“Autostrada Energjetike Kosovë-Shqipëri”**.

Harta e Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës 2021





www.kostt.com